



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër:400-01/34683, dt. 04. Maj 2022.

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja c), nenit 17, pika b) dhe nenit 40 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.12, nenit 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPHI-nr..05/2014 për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Hapësinor, nenit 4 , paragrafi 3 pika 3.2, nenit 5, neni 7, nenit 8, nenit 10, nenit 12 ,nenit 13, nenit 14, nenit 15 ; si dhe mbështetje të nenit 19 pika 1.2, 1.3, 1.5, nenit 51 , nenit 60 pika 2.6 , nenit 83 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës,01.Numër : 01-016/01-413431 datës 30 shtator 2020 , Kuvendi i Komunës së Pejës në mbledhjen e mbajtur ma datë : 04. Maj 2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Nr.29/2022

Për shqyrtimin publik të projekt – “ Hartës Zonale të Komunës së Pejës 2022-2030”

Neni 1

Me këtë vendim shpallet në shqyrtim publik projekt – “Harta Zonale e Komunës së Pejës 2022-2030 “

Neni 2

2.1 Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i projekt – Harta Zonale e Komunës së Pejës 2020-2030 bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës , 8 (tetë) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2.2 Ekspozimi i projekt –Hartës Zonale të Komunës së Pejës bëhet në hollín e ndërtesës së Kuvendit të Komunës.

2.3 Për prezantimin e Hartës Zonale të Komunës së Pejës bahet procesverbali .

2.4 Shqyrtimi publik i projekt –“ Harta Zonale e Komunës së Pejës 2022-2030” zgjatë 30 (tridhjetë) ditë sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

2.5 Shpallja e shqyrtimi publik të projekt – “Harta Zonale e Komunës së Pejës- 2022 - 2030 “ bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes se tij përmes mjeteve të informimit publik , përkatësisht tri (3) gazeta të përditshme , faqen e internetit të komunës dhe në mediat televizive – publik dhe lokale .

Neni 3

3.1 Në shqyrtimi publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projekt –“Harta Zonale e Komunës së Pejës 2022-2030” .

3.2.Në shqyrtimin publik prezantohet fazat e projekt – “Harta Zonale e Komunës së Pejës 2022- 2030 “ si:

- Profili i Komunës
- Vlerësimi i Gjendjes
- Vizioni , qëllimet dhe objektivat ,
- Koncepti i Zhvillimit, duke përfshirë të gjitha anekset .

3.3 Projekt –Hata zonale e Komunës së Pejës 2022-2030 është i çashëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike .

Neni 4

4.1 Projekt –Harta Zonale e Komunës së Pejës i nënshtrohet vërejtjeve komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet .

4.2 Të gjitha vërejtjet me komente dhe sugjerime që paraqitën nga publiku me gojë gjatë diskutimeve , me shkrim shënohen në librin e vërejtjeve, apo përmes adresës elektronike brenda afatit kohor , përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Neni 5

5.1 Shqyrtimi publik i projekt – Harta zonale e Komunës së Pejës 2022-2030 organizohet nga Komuna e Pejës në suaza të kompetencave me ligj.

Neni 6

6.1 Me këtë vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik të projekt –Harta Zonale e Komunës së Pejës 2022-2030.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi është përgjegjës Autoriteti përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menagjim Hapësinor –Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunalë Pejë , dhe do të shpallet në faqen zyrtare të Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

- 1x1 MAPL-së
- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 DUMM.
- 1x1 Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT ,
z. Rexhep Kurtbogaj